

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. Protokolit:340

Datë: 21.09.2026

Për: Kuvendin e Komuës së Suharekë
Përmes: Bali Muharremajt, Kryetari i Komunës,
Nga: Remzi Bajselmani- Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit-Suharekë
Lënda: Raport për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 dhe fillimin e vitit shkollor 2026/2027

HYRJE

Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë, në kuadër të përgjegjësi të saj për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e institucioneve edukativo-arsimore, ka realizuar aktivitetet e nevojshme për përfundimin e rregullt të vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjen e Institucioneve arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027.

Ky raport paraqet gjendjen e përgjithshme të procesit edukativo-arsimor, aktivitetet e realizuara, rezultatet e arritura, sfidat e evidentuara dhe masat e ndërmarra nga DKA-ja si dhe aktivitetet e zhvilluara në funksion të përgatitjes së vitit të ri shkollor.

Në Komunën e Suharekës funksionojnë gjithsej **33 Institucione të arsimit dhe edukimit**, duke përfshirë Institucionet e arsimit parauniversitar dhe Institucionet parashkollore.

Përfundimi i procesit mësimor

Viti shkollor 2025/2026 është përmbyllur në Institucionet arsimore të Komunës së Suharekës në përputhje me kalendarin shkollor dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit, dhe Shkencës. Në përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 Komuna e jonë kishte të regjistruar :

Gjithsej 8409 nxënës, deri sa në vitin paraprak (2024/2025) kishte 8599, që do të thotë **190 më pak** dhe ate:

Çerdhja publike	371 fëmijë
Çerdhet private	176 fëmijë
Arsimi Para Fillor	435 parashkollorë
Arsimi Fillor	3023 nxënës
Arsimi i msëm i ulët	2678 nxënës
Arsimi i Mesëm i lartë	1726 nxënës

Në bazë të legjistacionit në fuqi, regjistrimet për vitin e ri shkollor 2026/2027 në sistemin SMIA fillon nga 7 shtatori deri më 20 tetor.

DKA-ja ka përcjellë vazhdimisht realizimin e procesit mësimor dhe ka kërkuar nga Drejtoritë e shkollave që përfundimi i vitit shkollor të bëhet në mënyrë të organizuar, duke përfshirë:

- përfundimin e planprogramit mësimor;
- përfundimin e vlerësimit të nxënësve;
- mbajtjen e mbledhjeve të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasave;
- përfundimin e dokumentacionit pedagogjik dhe administrativ;
- evidentimin e suksesit dhe vijueshmërisë së nxënësve;
- raportimin e gjendjes së përgjithshme nga drejtoritë e shkollave.

Shkollat kanë dorëzuar dokumentacionin dhe raportet e kërkuara nga DKA-ja lidhur me përfundimin e vitit shkollor.

Rezultatet dhe suksesi i nxënësve

Në përfundim të vitit shkollor është bërë evidentimi i suksesit të nxënësve sipas niveleve dhe klasave. DKA-ja ka kërkuar nga Institucionet arsimore që procesi i vlerësimit të jetë i bazuar në kriteret profesionale dhe në dokumentacionin përkatës pedagogjik. Në rastet kur janë paraqitur kërkesa për rishqyrtim të vlerësimit apo ankesa nga prindërit/nxënësit, ato janë trajtuar në përputhje me kompetencat ligjore dhe procedurat përkatëse.

Në tabelë janë paraqitur të dhënat për suksesin e nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në komunën e Suharekës:

Niveli arsimor	Gjithsej rumri i nxënësve	Nr.i nx.të notuar	Nr.i nx.të pa-notuar	Suksesi Pozitiv	% e suksesit pozitiv	Nota mesatare
Arsimi Fillor	2993	2942	51	2882	96%	4.21
Arsimi I Mesëm I Ulët	2770	2725	45	2511	91%	3.61
Arsimi I Mesëm I Lart	1662	1662	0	1625	98%	3.57
Gjithsej	7425	7329	96	7018	96%	3.78

Nga tabela konstatohet se numri gjithsej i nxënësve është 7425, nga të cilët janë notuar 7329 dhe janë pozitiv 7018 ose 96%, kurse me sukses negative janë 311 nxënës ose 4%. Nota mesatare ishte 3.78.

Mbështetja e nxënësve dhe përfshirja në arsim

Një ndër prioritetet e DKA-së gjatë vitit shkollor ka qenë sigurimi i qasjes dhe përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-arsimor.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve të nxënësve me nevoja të veçanta, ku aktualisht në sistem in SMIA janë të evidentuar 50 raste me nevoja të ndryshme të veçanta.

Bazuar në vendimin e Kryetarit 01Nr.016-12697, të datës 19.03.2026 dhe në raportin e ekipit të FNV-së, del se në vitin shkollor 2025/2026 kanë pasur gjithsej 28 kërkesa për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta duke pasur parasysh që ekipi është formuar në muajin mars 2026 është arritur të vlerësohen 18 raste ndërsa rastet tjera pritet të shyrtohen/vlerësohen gjatë vitit shkollor 2026/2027.

Në procesin arsimor aktualisht janë të angazhuara 20 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, por karshi rasteve dhe nevojave të paraqitura, këto asistente nuk mund të mbulojnë perkujdesjen për të gjitha rastet

Aktivitetet jashtëkurrikulare dhe garat

Gjatë vitit shkollor 2025/26 Institucionet arsimore kanë realizuar aktivitete kulturore, sportive, shkencore dhe gara të ndryshme. Nxënësit e Komunës së Suharekës kanë marrë pjesë në gara komunale dhe aktivitete në nivel më të lartë.

DKA-ja ka mbështetur organizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitete të tilla me qëllim të zhvillimit të talentit, kreativitetit dhe shkathtësive të tyre ku janë realizuar dhe në fund të vitit shkollor ka organizuar ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve /mirenjohjeve:

Lista e nxënësve dhe arritjet në Garat për vitin 2025/2026

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Klasa	Shkolla	Vendi	Emri i garës	Arritjet /vendi	Niveli i garës
1	Bleron Berisha	XII	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	2	Shtetëror
2	Stina Berisha	IX	SHFMU " D. Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	3	Shtetëror
3	Vlera Veselaj	IX	SHFMU " D. Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	3	Shtetëror
4	Tuana Spahiu *	VII	SHFMU " D. Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	3	Shtetëror
	Tuana Spahiu	VII	SHFMU " D. Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	1	Komunal
5	Majlinda Rrafshi	VIII	SHFMU " Sadri Duhla	Duhël	Olimpiada e Fizikës	3	Shtetëror
6	Orgesa Rrafshi	VII	SHFMU " Sadri Duhla	Duhël	Olimpiada e Fizikës	2	Komunal
7	Rea Gashi	VII	SHFMU " D. Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	2	Komunal
8	Drion Kafexholli	XI	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Fizikës	1	Komunal
9	Eros Kabashih	X	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	1	Komunal
10	Morena Kuçi	X	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	2	Komunal
11	Drion Kafexholli	XI	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	1	Komunal
12	Diellona Zenelaj	XI	IAAP " Abdyl Ramaj"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	2	Komunal
13	Anita Matoshi	XII	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	1	Komunal
14	Adea Kuçi	XII	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Kimisë	2	Komunal
15	Dunit Bytyqi	VII	SHFMU "K.i Manastrit"	Studenqan	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
16	Enea Selimi	VII	SHFMU " Edit Durham"	Mushtisht	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
17	Alea Hoxha	VIII	SHFMU"Destan Bajraktari"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
18	Denisa Llugaxhiu	VII	SHFMU" D. e Kombit"	Vraniq	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
19	Diona Buqaj	IX	SHFMU" N.Veqilhargji"	Mohlan	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
20	Sinera Zenelaj	IX	SHFMU "Migjeni"	Gjinoc	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
21	Altin Krasniqi	X	IAAP" Skënder Luarasi"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
22	Lorena Bytyqi	X	IAAP" Skënder Luarasi"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
23	Nina Berisha	X	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	3	Komunal
24	Drion Kafexholli	XI	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
25	Erleta Lumi	XI	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
26	Jon Berisha	XI	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	3	Komunal
27	Adea Kuçi	XII	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	1	Komunal
28	Rinesa Abdullahu	XII	Gjimnazi " Jeta e Re"	Suharekë	Olimpiada e Matematikës	2	Komunal
29	Elida Grulaj	IX	SHFMU"Destan Bajraktari"	Suharekë	Botim i librit		

Një rezultat i veçantë është shpallja e nxënësës së dalluar të Komunës së Suharekës për vitin shkollor 2025/2026. Ky vlerësim iu nda nxënësës **Altina Palushi**, e cila arriti rezultate të jashtëzakonshme në Olimpiadën e Gjuhës Shqipe në të gjitha nivelet – shkollor, komunal, shtetëror dhe në garën Kosovë–Shqipëri, duke fituar **vendin e parë në garën mes dy shteteve** dhe duke u bërë një shembull frymëzimi për të gjithë nxënësit

Inspektimi dhe monitorimi i Institucioneve

DKA-ja ka realizuar aktivitete të monitorimit të institucioneve arsimore, me fokus në:

- organizimin e procesit mësimor;
- vijueshmërinë e mësimdhënësve;
- zbatimin e planprogrameve;
- dokumentacionin pedagogjik;
- vlerësimin e nxënësve;
- menaxhimin e institucioneve;
- sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

Për rastet ku janë evidentuar mangësi, drejtorive të shkollave u janë dhënë rekomandime për përmirësim.

Gjendja e infrastrukturës shkollore

Gjatë vitit shkollor është përcjellë gjendja e objekteve shkollore dhe nevojat për intervenime.

Veçanërisht, pas dëmtimeve të shkaktuara nga kushtet atmosferike gjatë muajit korrik 2026, janë evidentuar dëmtime në disa objekte shkollore, përfshirë çatitë, ulluqet dhe pjesë të fasadave.

Për këto dëmtime janë përgatitur raportet përkatëse teknike dhe janë evidentuar nevojat për intervenim dhe mbështetje financiare.

DKA-ja ka kërkuar që ndërhyrjet e nevojshme të realizohen para fillimit të plotë të procesit mësimor, me qëllim të sigurimit të kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për nxënësit dhe personelin.

Bursat komunale për studentë dhe nxënës

Për vitin shkollor 2025/26, bazuar në kriteret e rregullores për ndarjen e bursave për studente dhe nxënës, komisioni ka bërë vendimin për ndarjen :

- 250 studentëve përfitues, prej të cilëve 190 janë të gjinisë femërore dhe 60 të gjinisë mashkullore, me bursë në vlerë prej 600.00 euro ;
- 100 nxënësve përfitues, prej të cilëve 78 janë të gjinisë femërore dhe 22 të gjinisë mashkullore, me bursë në vlerë prej 300.00 euro .

Rezultati i Matures shtetërore për të gjitha shkollat, qershor 2026

	Morën pjesë në provim nga tri shkollat	Kaluan	Nuk kaluan
M	231	139	90
F	295	182	113
Gjithsej	526	321	203
%		61.41%	38.59%

Rezultati i Matures shtetërore për të gjitha shkollat, gusht 2026

	Morën pjesë në provim nga tri shkollat	Kaluan	Nuk kaluan
M	67	39	28
F	87	42	45
Gjithsej	154	82	72
%		53.25 %	46.75 %

PËRGATITJET PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

Në funksion të përgatitjes së vitit shkollor 2026/2027, DKA-ja ka kërkuar nga institucionet arsimore përgatitjen dhe dorëzimin e të dhënave për:

- numrin e nxënësve;
- numrin e klasave/paraleleve;
- planifikimin e klasave të para;
- planifikimin e klasave të dhjeta;
- numrin e mësimdhënësve;
- normën mësimore të stafit;
- nevojat për kuadër të ri;
- nevojat për zëvendësime;
- nevojat për staf mbështetës dhe administrativ.

Për vitin shkollor 2026/2027, shkollat janë obliguar që planifikimet për klasat, paralelet dhe stafin t'i dorëzojnë në DKA sipas afateve të përcaktuara.

Gjendja e stafit mësimor

Një nga çështjet kryesore të evidentuara gjatë planifikimit të vitit 2026/2027 është menaxhimi i burimeve njerëzore.

Nga të dhënat e institucioneve janë evidentuar raste të:

- mësimdhënësve pa normë të plotë;
- orëve të lira që mund të shfrytëzohen për plotësimin e normës;
- nevojave për kuadër në profile të caktuara;
- profileve ku kërkesa e nxënësve është më e lartë;

DKA-ja ka analizuar të dhënat e dorëzuara nga shkollat me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të kuadrit ekzistues. Aktualisht në sistemin SMIA janë të evidentuar gjithsej **1022** të punësuar, prej tyre **838** mesimdhënës, **57** staf administrativ dhe **127** puntorë ndihmës

Arsimi profesional

Në Institucionet e arsimit profesional është bërë planifikimi i profileve në bazë të interesimit të nxënësve, nevojave të tregut dhe kapaciteteve të shkollave, për vitin 2026/2027 kemi vazhduar me disa profile profesionale me mesim dual:

- Rrobaqepësi – mesim dual;
- Automekanik – mesim dual;
- Tregti me shumice dhe pakice- mesim dual
- Hoteleri -mesim dual
- Kuzhinier -mesim dual

Përgatitja e dokumentacionit për fillimin e vitit shkollor

Institucioneve arsimore u është kërkuar që para fillimit të vitit shkollor të përfundojnë:

- oraret mësimore;
- ndarjen e klasave;
- angazhimin e mësimdhënësve;
- planin vjetor të punës;
- dokumentacionin pedagogjik;
- planet e kujdestarisë;
- evidencat e nxënësve të regjistruar.

Siguria në Institucionet arsimore

Në përgatitje për vitin e ri shkollor, DKA-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë së nxënësve dhe personelit.

Institucionet shkollore janë udhëzuar të bashkëpunojnë me mekanizmat relevantë, përfshirë Policinë e Kosovës dhe të kenë të përditësuara planet dhe procedurat e reagimit në raste emergjente.

Gjendja e objekteve para fillimit të vitit shkollor

Para fillimit të vitit të ri shkollor janë evidentuar nevojat për intervenime në disa objekte shkollore.

Në mënyrë të veçantë, dëmtimet e shkaktuara nga kushtet atmosferike në korrik 2026 kanë kërkuar angazhim shtesë të Komunës dhe DKA-së.

Për objektet e dëmtuara janë përgatitur të dhënat dhe dokumentacioni teknik përkatës, duke përfshirë përshkrimet e dëmtimeve, paramasat dhe vlerësimet financiare.

Qëllimi kryesor ka qenë që objektet të jenë të sigurta dhe funksionale për zhvillimin e procesit mësimor.

Sfidat kryesore

Nga analiza e përfundimit të vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjeve për vitin 2026/2027, DKA-ja ka evidentuar këto sfida kryesore:

- **Rënia e numrit të nxënësve dhe klasave**, e cila ndikon drejtpërdrejt në planifikimin e stafit.
- **Mësimdhënësit pa normë të plotë**, si pasojë e numrit të reduktuar të paraleleve.
- **Orët e lira dhe nevoja për riorganizim të stafit** ndërmjet institucioneve.
- **Nevoja për mirëmbajtje dhe renovim të objekteve shkollore.**
- **Dëmtimet e objekteve nga kushtet atmosferike.**
- **Rastet e mungesave dhe rrezikut të braktisjes së shkollimit.**
- **Nevoja për forcimin e shërbimeve profesionale**, përfshirë mbështetjen psikologjike dhe pedagogjike, asistente për fëmijë me nevoja të veqanta
- **Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit.**

Rekomandime

Për adresimin e sfidave të evidentuara, DKA-ja planifikon:

- vazhdimin e monitorimit të rregullt të institucioneve arsimore;
 - mbështetjen e arsimit profesional dhe zhvillimin e profileve me interes për nxënësit;
 - forcimin e bashkëpunimit shkollë–prind–DKA;
 - identifikimin me kohë të nxënësve në rrezik të braktisjes;
 - rritjen e mbështetjes profesionale për nxënësit;
 - vazhdimin e investimeve në infrastrukturën shkollore;
 - sanimin me prioritet të dëmtimeve që paraqesin rrezik për sigurinë;
 - përmirësimin e kushteve për nxënësit me nevoja të veqanta;
 - zhvillimin profesional të vazhdueshëm të stafit;
 - forcimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë;
-

Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë vlerëson se viti shkollor **2025/2026 është përmbyllur me angazhimin e institucioneve arsimore dhe stafit të tyre**, ndërsa përgatitjet për vitin shkollor **2026/2027** janë realizuar përmes planifikimit të klasave, nxënësve, kuadrit mësimor, dokumentacionit pedagogjik dhe administrativ si dhe adresimit të çështjeve infrastrukturore.

Megjithatë, planifikimi i vitit të ri shkollor kërkon vazhdim të angazhimit institucional për shkak të ndryshimeve demografike, zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe paraleleve, menaxhimit të normës së mësimdhënësve, nevojave për profile të caktuara profesionale dhe nevojave për investime në infrastrukturën shkollore.

DKA-ja do të vazhdojë monitorimin e Institucioneve arsimore dhe bashkëpunimin me drejtuesit e shkollave, Komunën, MASH-In dhe institucionet e tjera relevante, me qëllim të sigurimit të një procesi edukativo-arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt.

Drejtoria Komunale e Arsimit – Suharekë

Drejtore Remzi Bajselmani



Suharekë, shtator 2026